

UDHËZIM
Nr. 49, datë 6.9.2013

**PËR PROCEDURAT E PRANIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË CIKLIN E DYTË TË
STUDIMEVE, ME KOHË TË PLOTË, “MASTER PROFESIONAL” DHE “MASTER
SHKENCOR/MASTER I ARTEVE TË BUKURA”, NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT
TË LARTË, NË VITIN AKADEMIK 2013-2014**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 34 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 744, datë 5.9.2013 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë, për ciklin e dytë të studimeve, me kohë të plotë, “Master profesional” dhe “Master i shkencave/ Master i arteve të bukura”, për vitin akademik 2013-2014”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 241, datë 31.3.2011 “Për kryerjen nga Posta Shqiptare sh.a. të shërbimeve postare, financiare dhe shërbimeve të tjera, që janë në përputhje me veprimtarinë e kësaj poste, për institucionet e qeverisjes qendrore e vendore, institucionet e tjera publike, si dhe shoqëritë tregtare me kapital shtetëror”,

UDHËZOJ:

1. Pranimin e aplikantëve brenda vendit, si dhe shqiptarëve nga trojet jashtë kufijve, në programet e studimit të ciklit të dytë, me kohë të plotë, “Master profesional” dhe “Master shkencor/ Master i arteve të bukura”, në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2013-2014, në bazë të përzgjedhjes së bërë nga institucionet publike të arsimit të lartë, sipas kriterëve të përcaktuara dhe të bëra publike paraprakisht.

2. Njësitë kryesore të institucioneve publike të arsimit të lartë organizojnë procesin e pranimit dhe të regjistrimit të aplikantëve në programet e studimit të ciklit të dytë, me kohë të plotë, “Master profesional” dhe “Master shkencor/ Master i arteve të bukura”. Procesi të monitorohet nga rektoratet dhe Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor në Ministrinë E Arsimit dhe Shkencës.

3. Institucionet publike të arsimit të lartë të shpallin menjëherë hapjen e procedurës së aplikimit të kërkesave për aplikantët brenda vendit, si dhe shqiptarëve nga trojet jashtë kufijve, që dëshirojnë të vijnë në programet e studimit të ciklit të dytë, me kohë të plotë, “Master profesional” dhe “Master shkencor/ Master i arteve të bukura”, datat dhe oraret e veprimeve të konkurrimit dhe të regjistrimit, procedurat përkatëse, listën e dokumenteve të nevojshme për regjistrim, si edhe njoftime të tjera që i gjykojnë të nevojshme për sigurimin e ecurisë normale të procesit të pranimeve. Këto njoftime të bëhen publike në median e shkruar dhe elektronike nga institucionet publike të arsimit të lartë.

4. Aplikimet për regjistrim në programet e studimit të ciklit të dytë, “Master profesional” dhe “Master shkencor/ Master i arteve të bukura”, të bëhen pranë sekretarive mësimore të njësive kryesore, nga data 9.9.2013 deri në datën 27.9.2013, prej orës 08:00 deri në orën 16:00, ku kandidati duhet të paraqitet personalisht dhe të dorëzojë dokumentacionin e mëposhtëm:

a) fotokopje të noterizuar të diplomës së ciklit të parë të studimeve, të shoqëruar me listën origjinale të notave;

b) dokument identifikimi (kartë identiteti ose pasaportë) dhe fotokopje të tyre. Në dosje të mbahet fotokopja e kartës së identitetit ose e pasaportës;

c) 2 fotografi;

d) mandat arkëtimi i tarifës së regjistrimit prej 2.500 lekë, paguar në Postën Shqiptare;

e) deklaratë e kandidatit që vërteton se nuk ndjek ndonjë program tjetër studimi të ciklit të dytë, “Master profesional” dhe “Master shkencor/ Master i arteve të bukura”, në institucionet publike të arsimit të lartë.

5. Pranë njësive kryesore përgjegjëse të institucioneve publike të arsimit të lartë për çdo program studimi të ciklit të dytë me kohë të plotë të ngrihen komisione të posaçme, sipas fushave përkatëse, për përzgjedhjen e aplikantëve fitues në përputhje me kriteret e pranimit, të vendosura dhe të shpallura publikisht nga këto institucione.

6. Institucionet publike të arsimit të lartë të shpallin dhe të afishojnë listat e aplikantëve fitues në vende të dukshme, në mjediset e njësive kryesore përkatëse, brenda orës 16:00 të datës 5.10.2013, të ndarë

sipas programeve të studimit përkatës, të renditur sipas rendit zbritës të pikëve të grumbulluara nga aplikantët, në përputhje me kuotat e pranimeve, të miratuara sipas vendimit nr. 744, datë 5.9.2013 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimi dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë, për ciklin e dytë të studimeve, me kohë të plotë, “Master profesional” dhe “Master i shkencave/ Master i arteve të bukura”.

7. Regjistrimi i aplikantëve në programet e studimit, ku janë shpallur fitues, të zhvillohet nga data 7.10.2012 deri në datën 11.10.2012, prej orës 08:00 deri në orën 16:00 pranë sekretarive mësimore të njësive kryesore të institucioneve publike të arsimit të lartë. Dokumentet e aplikantëve jofitues t’u kthehen personave kundrejt kërkesës. Për regjistrimin, kandidati duhet të paraqitet personalisht pranë sekretarive mësimore dhe të paraqesë në origjinal dokumentet sipas shkronjës “a” dhe “b” të pikës 4 të këtij udhëzimi.

8. Me mbylljen e regjistrimit përfundimtar, institucionet publike të arsimit të lartë të dorëzojnë në Agjencinë Kombëtare të Provimeve (AKP) listat përfundimtare në dy kopje, në formë të shkruar dhe elektronike, me regjistrimet e kryera për çdo program studimi të ciklit të dytë “Master profesional” dhe “Master shkencor/ Master i arteve të bukura”, të plotësuar, sipas shtojcës nr. 3 të udhëzimit nr. 45, datë 19.12.2011 “Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit”, të ndryshuar.

Kandidatët që rezultojnë të regjistruar në programe të tjera studimi të ciklit të parë ose të dytë, me kohë të plotë apo të pjesshme në IAL-të publike, nuk marrin numër matrikullimi. AKP-ja pas verifikimit i kërkon IAL-ve t’i çregjistrojë ata.

9. Ngarkohen Zëvendësministri i Arsimit dhe Shkencës, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, si dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj